



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 15 Prot

Tiranë, më 08.02., 2013

**VENDIM Nr. 241, datë 08.02.2013**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 08.02.2013, pasi shqyrtoi "Raportin përfundimtar mbi sondazhet arkeologjike të kryer në sheshin e ndërtimit me adresë: Lagjja Nr. 18, Rruga "14 Nëntori", zona arkeologjike "B", Durrës, paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik mbi bazën e kërkesës të **Subjektit "G&S" sh.p.k.**,

**VENDOSI:**

- I. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës të thellojë një nga sondazhet arkeologjike për t'u siguruar që është arritur shtresa sterile.
- II. Të plotësohet raporti i sondazheve arkeologjike, përgatitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Durrës për sheshin e ndërtimit të subjektit "G&S" sh.p.k.: Lagjja Nr. 18, Rruga "14 Nëntori", zona arkeologjike "B", Durrës, me rezultatet e këtij sondimi shtesë.
- III. Relacioni me plotësimet të paraqitet për miratim në mbledhjen e radhës së KKA.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**ALDO BUMÇI**

**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**

**ROLAND OLLI**



AGJENCIA E  
SHËRBIMIT  
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,  
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171

Web: [www.asha.gov.al](http://www.asha.gov.al)